

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Gjykatës së Lartë - Shkërmoqen iluzionet e Erion Veliajt, mbetet në burg!
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916745/shkermogjen-iluzionet-e-erion-veliajt-mbetet-ne-burg/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:29:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0e730d6749dce587a538c7923d9cb251dc09b0b55acc97fcc03174f991bc7017
TEKSTI	14ca67dec9e53cf103554188533baf63b2af6a72e1c4a45942cea90900e8e355
PAMJA	c009f5d6b210593504976439a4506b209a4932fb0570ed4af04cd3251efa8edd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac0ab668459476714a6fccb242c6409a31eeb0090cd14297444816cd9053b2d7
E MËPARSHMJA	b693ffb29ff63e5af5535134adf7e3009b31b20d579d7829dbc238bfce80aafb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac0ab668459476714a6fccb242c6409a31eeb0090cd14297444816cd9053b2d7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**IRENA BEQIRAJ**Fashizmi nuk duhet kërkuar
tek revolta e protestuesve por
në Kuvend!**AGIM XHAFKA**

Dialog me mbesën



Shkërmoqen iluzionet e Erion Veliajt, mbetet në burg!

11:08, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Shkërmoqen iluzionet e kryetarit të bashkisë së Tiranës Erion Veliaj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi sot të mos ndryshojë masën e sigurisë 'arrest me burg', në të cilën ndodhet prej 10 shkurtit 2025.

Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e 13 marsit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, duke rrëzuar kërkesën e mbrojtjes për ndryshimin e masës së sigurisë ndaj kryetarit të Bashkisë së Tiranës me një masë më të butë sigurie.

Vendimi u dha nga 3 gjyqtarët e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Sandër Simoni, Genti Shala dhe Valbon Çekrezi, pasi u mbledhën në Dhomën e Këshillimit për më shumë se një orë. (Mbledhja nisi në 09:30 dhe vendimi u njoftua në 11:11).



Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i mbledhur në datë 15 shtator 2026, në Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim dosjen penale me palë:

Kërkuar: Erion Veliaj, Palë e Interesuar: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe objekt: Shfuqizimin e vendimeve nr. 7, dt. 09.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkalles së Pare për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlefesuar përmes vendimit nr. 14, dt. 12.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkalles së Pare për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 13, dt. 13.03.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1153 (176), dt. 08.07.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Shpenzimet gjyqesore në ngarkim të subjektit të interesuar.

Pasi shqyrtoi çështjen, Kolegji, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja "e" të Kodit të Procedurës Penale, vendosi: Lënien në fuqi të Vendimit nr.13 (87-2025-85), datë 13.03.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, thuhet në njoftimin e

më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne të emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

Rigjykimi bëhet në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të majit 2026, që vlerësoi se Gjykata e Lartë nuk kishte arsyetuar se përse 'arresti në burg' ishte e vetmja masë e përshtatshme dhe as proporcionalitetin e kësaj mase me funksionin e Veliajt si kryebashkiak.

Veliaj në burg prej shkurtit 2025

Kryebashkiaku i Tiranës mbahet në paraburgim që prej 10 shkurtit të vitit 2025, ndërsa paralelisht vijon procesi gjyqësor në themel, ku ai përballet me akuza për korrupsion, pastrim parash, fshehje pasurie, shpërdorim detyre dhe futje të sendeve të palejuara në ambientet e paraburgimit, të cilat kryebashkiaku i ka mohuar.

Ai akuzohet zyrtarisht për 9 episode të "korrupsionit pasiv të funksionarëve të zgjedhur", për "pastrim të produkteve të veprës penale-pastrim parash" dhe "fshehje të pasurisë".

Brenda vendimi jashtë protesta

Mbledhja e sotme në Dhomën e Këshillimit është bërë me dyer të mbyllura, pa prezencën e palëve por mbështetur mbi aktet që kanë paraqitur palët në këtë proces.

E ndërsa gjyqtarët po vendosnin jashtë ambienteve të gjykatës u mblodhën disa protestues.

Aktivisti Edison Lika tha përpara shpalljes së vendimit se, çështja nuk lidhet me dëmin që sjell qëndrimi i kryebashkiakut në burg, por me lirin e tij dhe faktin që ai vijon të mbajë detyrën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Ndërsa pas vendimit u dëgjuan brohorimat e tyre "Rama n'burg Veliaj n'burg". Avokatët shqiptarë dhe të huaj të Erion Veliajt kanë paralajmëruar se do ta çojnë çështjen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO-SYRI TV/ Daja i Zegjine Çaushit përdhunon 34-vjeçaren dhe i masakron babanë, rrëfimi tronditës: Duam mbrojtje



VIDEO/ 'Erion Veliaj', si të duket qelia? Protestuesit festojnë vendimin e Gjykatës së Lartë



Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimit prioritet

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

Shkërmoget iluzionet e Erion Veliajt, mbetet në burg!

TË NGJASHME



Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë



PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij



Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale



‘Lini Veliajn në qeli!’ Protestuesi para Gjykatës së Lartë: Në Tiranë paratë u pastruan përmes ndërtimit, me bekimin e tij



‘Nëse Veliaj lirohet, loja politike do të përfundojë keq’, Gjokutaj: E stisur nga Rama, është tragjikomedi



VIDEO/ ‘O gjykatës bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli!’ Qytetarët protestojnë para Gjykatës së Lartë



Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve / PD kërkon seancë dëgjimore me Sokol Sadushin, kryeprokurorin, KLGJ, KLP...



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.